

NJOFTIM PËR SHITJE PËRMES ANKANDIT TË PARË PUBLIK

Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj, ka sjellë Konkluzion për lëndën **P.nr.629/17**, mbi shitjen e paluajtshmërive të hipotekuara në favor të bankës BKT, të evidentuara sipas parcelës me numër **P-71712004-01191-0**, me sipërfaqe prej 1,678 m², **P-71712004-01192-0**, me sipërfaqe prej 340 m², dhe **P-71712004-01198-0**, me sipërfaqe prej 4,420 m², që të tri këto parcela gjenden në vendin e quajtur "Arat e Nishefcve", Zona Kadastrale Balloc, Komuna Kadastrale Podujevë, të evidentuara në emër të pronares Mirvete Nishefc, të bllokuara/hipotekuara në favor të kreditorit Banka Kombëtare Tregtare Kosovë SH.A.

Këto pasuri të përshkruara më lartë do të shiten përmes Ankandit të Parë Publik, në mbështetje të plotë të dispozitës së Nenit 227 të LPP-së, me qëllim të sigurimit të mjeteve për të përmbushur detyrimet që debitorët Kompania Mjedrra Sh.P.K. (dhe të tjerët), kanë ndaj kreditorit – **Banka Kombëtare Tregtare Kosovë SH.A.**

» Vlera e paluajtshmërive është vlerësuar në shumën prej: **22,500.00 €** (njëzet e dy mijë e pesëqind) Euro, pasuri të cilat në këtë ankand të parë të shitjes publike mund të shitet nën vlerën e përcaktuar, por jo nën 1/2 e vlerës së përcaktuar.

- Data e Ankandit të Parë Publik: **23.11.2020**
- Koha e shitjes – ora: **11:00**
- Vendi i shitjes: **Përmbartues Privat Destan Bujupaj, Rr. Perandori Dioklecian, Obj. 4, Nr. 15, Prishtinë.**

Të gjithë të interesuarit duhet të deponojnë tek përmbartuesi privat shumën prej 10 % të vlerës së cekur të paluajtshmërisë por jo më shumë se 5,000 Euro në emër të kaucionit, para se të fillojë shitja, por jo më vonë se data 22.11.2020, me të drejtë të kthimit të kaucionit pas përfundimit të ankandit, ofertuesve të pasuksesshëm.

Për informata me të hollësishme, ju lutem, kontaktoni në tel: 038 666 666; 045/700-790.

Prishtinë, 2020



038 666 666 | www.bkt-ks.com

Ne jemi gjithmonë këtu!